

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë **20.05.2024**, në **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr.5112 Prot., datë 17.05.2024 (N.U. 357 dt.17.05.2024) të titullarit të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

Autoritetit kontraktor: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë

Lloji i procedurës:Procedurë e hapur e thjeshtuar

Objekti: “Blerje pajisje kompjuterike dhe aksesore për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): 30200000-1, 30213300-8, 30213100-6, 30213200-7, 44233000-2

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-05208-05-17-2024

Data e zhvillimit do të jetë **03.06.2024** , ora **09:00**. në adresën www.app.gov.al

Vlera e fondit limit: 4,083,333 (katër milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH.

Grupi i punës për përcaktimin e fondit limit, i ngritur me anë të urdhrin të brendshëm nga titullari i AK, ka perlllogaritur vleren e fondit të nevojshëm për këtë objekt prokurimi, mbështetur në mesataren e ofertave të marra nga testimi i tregut. Nga sa më sipër ka hartuar procesverbalin mbi vendosjen e fondit limit për procedurë me objekt **“Blerje pajisje kompjuterike dhe aksesore për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”**

Është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me objekt: **“Blerje pajisje kompjuterike dhe aksesore për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”**, të mos kryhet e ndarë në lote nisur nga natyra e mallrave që do të furniyohen. Ky mall duhet të ofrohet nga një operator ekonomik sipas kushteve dhe standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike pjesë e këtyre dokumentave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.” si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar shtojcës 7 pika 1 e saj, ofertuesi duhet të deklarojë që përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8.

Argumentimi:

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

“Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës,”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Blerësi dhe Shitësi.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 55, pika 4, b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat e lëshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente e saj në fushën e menaxhimit të cilësisë;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në :

- nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);

- nenin 44, pika 1 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe demonstron aftësinë për të siguruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e klientit. Certifikimi ISO 9001:2015 vërteton se një kompani që e posedon atë, ka përmbushur standardet e cilësisë sipas atyre ndërkombëtare dhe lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si një kompani/operator ekonomik e zhvillon/përmirëson biznesin e tij në lidhje me përmbushjen e kërkesave të klientit.

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknik ose broshurë për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu apo broshura të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat standarde të tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun teknik apo broshurën e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre).

Argumentimi:

Kriteri i mesiperm është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 4 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” dhe piken 6/b të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara.
- 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike, dhe do të jenë të njëjtë me fotografitë/katalogët/broshurat e paraqitura në procedure.
- 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jete sipas specifikimeve teknike, nga momenti i lëvrimin të tyre. Gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konforme specifikimeve teknike.
- 2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi do të jenë origjinale, të reja, nuk do të jenë të ricikluara, nuk do të jenë të riprodhuara, do të jenë të paketuara e të pahapura.

Argumentimi ligjor: Nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteret e mesiperme sigurojnë AK-në se produktet objekt prokurimi, do të jenë pajisje të reja (jo të përdorura apo riparuar) sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST-të dhe do të sigurojnë, që pajisjet do të jenë cilësore dhe performante gjatë përdorimit. Kërkohet garanci që pajisjet e ofruara të jenë të reja të asamblyuara me të gjitha pjesët origjinale, modelet koherente, në përputhje me standardet europiane të kësaj fushe, parë sensibilitetin dhe qëllimin ku do të instalohen si institucion i rëndësishëm së veçantë.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesit i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Sasia dhe specifikimet: Sipas tabelës nr.1

Artikulli	Përshkrimi	Shuma (Sasia - copë)
1	Kompjuter (Monitor, Njesi qendrore dhe aksesore)	7
2	Laptop	2
3	Laptop ADVANCE	1
4	Workstation	1
5	Tableta	50
6	Fisha rrjeti me gjatesi 5 m	18
7	Fisha rrjeti me gjatesi 10 m	20
8	Fisha rrjeti me gjatesi 15 m	15
9	Fisha rrjeti me gjatesi 20 m	10

Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, institucion i cili aktivitetin kryesor e ka në terren. Për të kryer detyrat e tyre funksionale, inspektorët e kanë të nevojshme të pajisen me tableta në mënyrë që të kenë mundësi të përshpejtojnë procedurat e tyre duke hedhur informacionin në kohë reale në aplikacione si Google Earth. Gjithashtu me anë të programeve të ndryshme që mund të shkarkohen, inspektorët kanë mundësi për të bërë dhe matje shumë të sakta të objekteve që inspektohen.

Për shkak të zgjerimit të vazhdueshëm që ka patur ky institucion gjatë viteve si dhe për shkak të rritjes së volumit të punës dhe lehtësimeve që teknologjia krijon për kryerjen e punëve të institucionit, na lind nevoja për pajisje: 7 Kompjuter, 1 Workstation dhe 3 laptopa. Gjithashtu lejon të instalojmë dhe menaxhojmë programe të ndryshme të nevojshme duke i siguruar përdoruesve akses në çdo moment, gjë që do rrisi produktivitetin dhe efizienzën në përgjithësi.

Laptopët gjithashtu janë shumë të nevojshëm pasi lidhen me detyra specifike të disa punonjësve në terren dhe që kërkojnë ndjekjen e një programi (e-lejet) edhe gjatë inspektimeve të tyre. Ky program i lejon ato që të shikojnë dokumentacionin dhe projektet e subjekteve që ushtrohet kontrolli, si dhe që ato të kenë mundësi të bëjnë preventivat e objekteve në mënyrë që të nxjerrin vlerën e gjobës. Kjo sjell domosdoshmëri në paisjen e 3 laptopëve për kryerjen efikase të detyrave që ato kanë.

- **SPECIFIKIMET TEKNIKE,**

Kompjuter Specifikimet teknike :

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	7900 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (3) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë	3 Vjet

“Warranty”:

- LAPTOP Bazik

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	4500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB HDD, 7200 RPM SATA
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW with DL Internal ose External; Memory card reader
Ekrani “Display”:	15.6” LED HD (1366 x 768), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Laptop ADVANCED

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	12200 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	≥ 500 GB SSD
“Graphics”:	Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW DL Internal ose External e të njëjtës Markë me Laptop-in; Memory Card Reader
Ekrani “Display”:	15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 60 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11 ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1;
“Sound”:	Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Workstation

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net	12000 Pikë
Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	
“RAM”:	32 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1).
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.
“Media Device”:	DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity
“Slots”:	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (10) USB nga të cilat: a. Min. (4) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal speakers or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC , 50 Hz
Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 23"
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
“Display Port”:	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI
Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC , 50 Hz

GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

TABLET

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

“Processor Cores”:	Octa Core
“RAM”:	3 GB
Memorie e Brendëshme “Internal Memory”:	32 GB
“Removable Memory”:	Të Suportojë Kartë Memorje min. 128 GB
“Sensors”:	Accelerometer, etj GPS- Internal
Ekran “Display”:	≥ 9.7” FHD (1920 x 1080) multitouchscreen
Bateria “Battery”:	6000 mAh ose min. 4 Orë Punë
Kamera “Camera”:	Kamera para min. 4 Megapixel Kamera kryesore min. 8 Megapixel

KOMUNIKIMI & MENAXHIMI

Portat e Komunikimit “Ports”:	Micro USB ose USB Tipi C
Rrjeti “Networking”:	3G Internet; 4G/LTE Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.0;
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	Po

AKSESORËT

Ushqyesi “Recharger”:	Po, European 220 V AC, 50 Hz
Flip Cover:	Po
Laps per tabletin	Po (jo detyrimisht i të njëjtës markë me tabletin)

GARANCIA

Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit
---	-------

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Fishat e Internetit te paisura ne te dy anet me koka rrjeti RJ45 Cat5e.

Specifikimet teknike (pjesë e DST- së)

Argumentimi:

Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar nga Specialisti i fushës Znj. D.D, bazuar në nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme,

lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me paisjet kompjuterike dhe aksesore duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për paisjet kompjuterike, janë vendosur parametra teknike sipas standarteve të përcaktuara nga AKSHI.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “**ose ekuivalente**” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Afatet e lëvrimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të kontratës **brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike**, përfshirë instalimin dhe vënien në efektivitet të plotë të pajisjeve objekt kontrate sipas direktivave të shërbimit të TIK-ut.